

LESIKU SHQIP I EVLIJA ÇELEBIUT I VITIT 1662 DHE Ç'DUHET TË DIJË DËRVISHI SHTEGTAR

Robert Elsie

Hyrje

Evliya Çelebi (1611-1684), emër letrar i Dervish Mehmed Zilli, i biri i argjendarit kryesor të oborrit Osman, lindi në Stamboll. Pasioni për udhëtime, ashtu siç e thotë vetë, i kishte mbetur nga një ëndërr që kishte parë në rini. Në vitet 1640-1676 Evlija Çelebiu kishte ndërmarrë udhëtimë të gjera nëpër Perandorinë Osmane dhe vendet fqinje, disa herë me regji private dhe herë të tjera me puna zyrtare. Ndër viset që kishte vizituar dhe përshkruar janë Stambolli, Kaukazi, Lindja e Mesme, Bullgaria, Vllahia, Mollldavia, Transilvania, Hungaria, Vjena, Serbia, Kroacia, Bosnja, Dalmacia, Shqipëria, Greqia, Rusia, Meka, Egjipti dhe Sudani.

Udhëtimet e gjera të Evlija Çelebiut, përjashtimore për atë kohë, janë shënuar në *Seyahatnamesi* (Libër udhëtimi) e tij në 19 vëllime të cilën autori e shkroi apo mbase e diktoi me t'u kthyer në Stamboll. Shumë pjesë të *Seyahatnamesi* duken të pakryera, në atë shkallë që mund ti pandehet se Evlija Çelebiu kishte vdekur para se të arrinte ta rregullonte dhe ta korrigjonte tekstin. Një numër dorëshkrimesh të veprës është ruajtur në Stamboll, Vjenë, Londër, Mynih, Bazel dhe Mançester. Pjesa më e madhe e *Seyahatnamesi* është botuar turqisht, ndërsa disa pjesë të rëndësishme janë botuar në përkthime (anglisht, gjermanisht, serbokroatisht, rusisht, hungarisht, greqisht, rumanisht, bullgarisht, maqedonisht e shqip). Për fat të keq, nuk ka ndonjë botim kritik shkencor të tërë veprë në asnjë gjuhë. Megjithatë, në dekadën e fundit kanë dalë disa vëllime kritike të korpusit të veprës si botime të veçanta.

Seyahatnamesi përmban shumë informata për historinë kulturore, folklorin dhe gjeografinë e vendeve që kishte vizituar Evlija Çelebiu. Për Shqipërinë e shekullit shtatëmbëdhjetë, dhe sidomos për brendinë e vendit, ajo përbën një minierë të vërtetë informatash dhe ka vlerë të paçmueshme.

Evlija Çelebiu vizitoi territoret e banuara nga shqiptarët në tri raste të veçanta. Vizita nga e cila kemi më së shumti informata është ajo të cilën e kishte ndërmarrë në verë të vitit 1670 në Shqipërinë jugore. Duke ardhur në Korfuzi, ai qëndroi në Delvinë, Gjirokastër, Tepelenë, Skrapar, Përmet, Berat, Kaninë, Vlorë, Bashtovë, Durrës, Kavajë, Peqin, Elbasan, Strugë, Ohër dhe Pogradec para se të vazhdonte më tej nëpër Maqedoni (Libri VIII, ff. 668—746 të botimit të vitit 1928). Përshkrimet e tij të gjata të Beratit dhe Elbasanit, në veçanti, japin dëshmi për një kulturë orientale të zhvilluar lartësisht në Shqipëri, nga e cila kanë mbetur pak gjurmë.

Dy udhëtimet e tjera të Evlija Çelebiut në Ballkanin jugperëndimor në përgjithësi janë shënuar më pak gjerësisht dhe ndoshta në mënyrë më të ngatërruar, por megjithatë japin informata intriguese. Më 1660 ai kaloi nëpër Kosovë dhe në rrugën e tij të kthimit për Stamboll u ndal në Mitrovicë, Zveçan, Vushtrri, Fushë Kosovë, Prishtinë dhe Kaçanik (Libri V, ff. 547-553 të botimit të vitit 1897).

Dy vjet më vonë, më 1662, ai pati rastin të vizitonte Shqipërinë e Veriut dhe Malin e Zi, duke ndaluar në Tiranë (kasaba-yi Tiran), Lezha (Lesh), Shkodër (Arnavud Iskenderiyyesi), Bushat (Bushatllar), Podgoricë (Podgoriç), Budva (Buduva), Tivar (Bar) dhe Ulqin (Ülgün), për t'u kthyer pastaj në Stamboll nëpër Alpet veriore shqiptare dhe Gjakovë (Libri VI, ff. 106-117 të botimit të vitit 1900).

Udhëtimet të vitit 1662 nëpër Shqipërinë e Veriut dhe Malin e Zi kurrë nuk i është

kushtuar shumë kujdes për shkak të problemeve dorëshkrimore dhe mungesës së përkthimeve. Botimi i vitit 1900 i Librit VI turqisht është posaçërisht i pasigurtë dhe, për arsye të ndryshme, disa pjesë të dorëshkrimit janë hequr. Një nga heqjet më jofatlume është pjesa të cilën Evlija Çelebiu e shënoi për gjuhën shqipe, përfshirë fjalorthin më 39 zëra në këtë gjuhë.

Fjalorthi shqip i Evlija Çelebiut është një ndihmesë e pazakonshme dhe e vlefshme për historinë gjuhësore dhe kulturore shqipe. Kishin kaluar saktësisht 2 shekuj nga koha kur ishte shënuar teksti i parë kohësisht i saktësueshëm dhe i kuptueshëm shqip, Formula e krishterë e pagëzimit: *Unte paghesont premenit Atit et birit et spertit senit* nga Pal Engjëlli (1462), dhe gjatë këtyre dy shekujve, në krahasim me gjuhët e tjera kombëtare të Europës, që shkruar pak gjë. Nga dokumentet më rëndësi të shqipes së hershme mund të përmenden teksti i ngatërruar i Bellifortisit i vitit 1405, nëse është vërtet shqip, dhe fjalorthi shqip i udhëtarit gjerman Arnold von Harff i vitit 1497, ky i fundit jo pa ngjashmëri me listën e fjalëve të Evlija Çelebiut. Në shekujt gjashtëmbëdhjetë dhe në fillim të shtatëmbëdhjetit u botua një numër i vogël librash shqip: i ashtuquajtur 'Meshar' i Gjon Buzukut (1555), Doktrina e krishterë e priftit sikulo-arbëresh Lukë Matranga (1592), katër veprat e Pjetër Budit (1618, 1621) dhe Fjalori latinisht-shqip i Franciscus Blancus apo Frang Bardhit (1635). Sido që të jetë, me përjashtim të fjalorit të fundit, veprat leksikografike dhe regjistrimet e vërteta të gjuhës në përgjithësi ishin ende të rralla në mesin e shekullit shtatëmbëdhjetë.

Fjalorthi i Evlija Çelebiut, i shënuar pa dyshim në Shkodër apo Bushat gjatë vizitës së tij atje më 1662, ka rëndësi edhe në një kuptim tjetër. Ai na ofron shënimin e parë të sharjeve në gjuhën shqipe. Edhe pse shqiptarët nuk përdonin sharje në asnjë mënyrë aq shpesh sa fqinjët e tyre sllavë të jugut (serbë, malazias, kroatë, boshnjakë e maqedonas), ata kanë, u muar vesh, një gamë të gjërë shprehjesh vulgare, ashtu siç ka, siç duket, çdo gjuhë. Nama më e hershme e shënuar shqip, *Dramburi te clofto gogle* (e trëmburi të qoftë goja) vjen nga viti 1483 dhe u zbulua në pjesën latinisht të Renesansës *Epirota* të Tommaso de Mezzo. Shënime të sharjeve / ekspletivëve të tjera shqip kemi pak deri në shekullin njëzet.

Si Arnold von Harffi para tij, Evlija Çelebiu kishte interesin të lartë për gjuhët e vendeve dhe të popujve që vizitoi. Nga udhëtimet e tij ai na jep tridhjetë e një lloj gjuhës joturke dhe së paku po aq gjuhësh turke dhe dialektesh. Imagjinata e tij në mbarështrimin e rrjedhëve të fjalëve nuk është me pak e gjerë se ajo e Isidorit të Sevijës një mijë vjet para tij. Robert Dankoff, profesor i Universitetit të Çikagos, të cilit jemi mirënjohës për tejshkrimin e tekstit osmanisht, e kishte përshkruar Çelebin si etimologjizues të pakorrigjueshëm. Një shembull i mirë për fantazinë e tij krijuese jepet këtu në shpjegimin e tij naiv për origjinën e popullit shqiptar.

Përkthimi i tekstit turqisht osmanisht

(Tejshkrimi osmanisht u theshtua këtu për arsye teknike. Krahas. botimin e mirëfilltë)

‘Sa i përket gjuhës, të gjithë ata flasin shqip, që nuk është si asnjë gjuhë tjetër. Në fillim shqiptarët ishin një prej fiseve arabe të Kurejshit në Mekë. Kjo është arsyeja pse ndër ta ende janë në përdorim disa fjalë arabe. Kur këta pjesëtarë shqiptarë të fiseve vërsuan prej maleve të Shkodrës dhe të Vlorës, ata u përzien me italianët dhe me frankët, dhe kështu, në kohën e kalifatit të Omarit krijuan një gjuhë midis arabishtes dhe frankishtes. Një paraqitje të arsyeve të kësaj gjëje dhe të preardhjes së shqiptarëve do të japim në një tjetër vend, por hëpërhë le të thuhet mbi gjuhën e shqiptarëve se persianët i thërrisnin *ar-na-bud* (‘të mos ketë turp’), dhe se disa kronikanë kështu e shkruanin. Është gjuhë e mrekullueshme, të cilën ata e flasin me devocion e mirësjellje kur i drejtohen njëri tjetrit me respekt. Të pabesët midis tyre mbahen të krishterë, edhe pse edhe kjo gjë, po ashtu, ngjet pas këmbënguljes së spanjollëve dhe

venedikasve. Përndryshe, ata janë shoqëri të pabesësh pa libra dhe kurvarësh që, si Zoroastrianët, nuk dinë gjë për Librin apo për tubimin final. Gjuha e tyre është si vijon:

”Le të fillojmë me **pörtuni zoti**, domethënë ‘për hir të Allahut’. Kur blejnë e shesin ata i numërojnë paratë e tyre si vijon: **nje** ‘një’, **dü** ‘dy’, **tiri** ‘tri’, **kotrá** ‘katër’, **pensi** ‘pesë’, **gasht** ‘gjashtë’, **ishtat** ‘shtatë’, **teti** ‘tetë’, **nandi** ‘nëntë’, **dit** ‘dhjetë’. **Falemi müre** ‘të fala, burra’, **aye shendosh enbahi** ‘a jeni mirë’, **mir nishtira nische** ‘mirë mëngjes’, **miliserde** [mirëseerdhët], **palá mizuni** [falemnderit], **buk** ‘bukë’, **uy** ‘ujë’, **mish** ‘mish’, **dele** ‘dele’, **puli** ‘pulë’, **bayá müre** ‘hajde, burrë’, **aha buk** ‘a ha bukë?’, **ku kiye** ‘ku qe?’, **miyalt** ‘mjaltë’, **aki te ki** ‘a ka elb?’, **nuku kam** ‘nuk kam’, **rush** ‘rrush’, **aki mebe teshin kurd** ‘sjell elb ose të çaj kokën’, **pörtuni zoti nuku kam aki** ‘për Allahu, nuk ka elb’, **támu** ‘nënë’, **motrá** ‘motër’, **shoke** ‘shoqe’. Këtu janë disa shprehje të vrazhda, por udhëtarët duhet t’i njohin, sepse mund të jenë të sulmuar apo të tallur: **hak mut** ‘ha mut’, **tikifshati támu** ‘të qifsha nënën’, **tikifshati shoke** ‘të qifsha shoqen’, **ti pirishte bihund** ‘të pjerdhsha në hund’, **tikifshati büti** ‘të qifsha në bythë’, **iç kivirdim** ‘ik shkërdhatë’. Shkurt, kur dervishët janë në udhëtim, ata duhet të dinë edhe shprehje të tilla, në mënyrë që të evitojnë shqëtësimet duke mos shkuar aty ku mund të ketë shpërdorim”.

Analizë e fjalorthit shqip

1. **pörtuni zoti** - Shqipe mod. *për tynëzot*.
2. **nje** - Shqipe mod. *një*.
3. **dü** - Shqipe mod. *dy*.
4. **tiri** - Shqipe mod. *tre* (m.), *tri* (f.).
5. **kotrá** - Shqipe mod. *katër*.
6. **pensi** - Shqipe mod. *pesë*.
7. **gasht** - Shqipe mod. *gjashtë*.
8. **ishtat** - Shqipe mod. *shtatë*.
9. **teti** - Shqipe mod. *tetë*.
10. **nandi** - Shqipe mod. *nëntë*.
11. **dit** - Shqipe mod. *dhjetë*.
12. **falemi müre** - Shqipe mod. *falemi, burra*. Përsëndetja *të falem* ende përdoret nga të vjetrit në Shqipëri.
13. **aye shendosh enbahi** - Shqipe mod. *a je shëndosh, a mbaheni?* Folja e dytë, në kontrast me të parën, është në formë shumës të respektit ju. Normalisht pritet ose njëjësi familjar *je shëndosh, a mbahesh?* ose shumës i respektit *a jeni shëndosh, a mbaheni?*
14. **mir nishtira nische** - Shqipe mod. *mirë ndeshtrasha, mirë ndesh (ty) të rasha*, kjo përsëndetje ende përdoret në dialektin e Shkodrës. Shih *ndeshtrashë* n.f. ‘ngjarje e papritur, takim’.
15. **miliserde** - Shqipe mod. *mirë se erdhe*.
16. **palá mizuni** - Shqipe mod. e mundshme *të falëm shumë*.
17. **buk** - Shqipe mod. *bukë*.
18. **uy** - Shqipe mod. *ujë*.
19. **mish** - Shqipe mod. *mish*.
20. **dele** - Shqipe mod. *dele*.
21. **puli** - Shqipe mod. *pulë*.
22. **bayá müre** - Shqipe mod. *pa eja, burra*. Në të folmen e Shkodrës ndeshet shpesh forma e reduktuar *p’eja*.

23. **aha buk** - Shqipe mod. *A ha bukë?*
24. **ku kiye** - Shqipe mod. *ku qe?*
25. **miyalt** - Shqipe mod. *mjaltë.*
26. **aki te ki** - Shqipe mod. *elb ti ke?* Nuk duket të ketë ndonjë gjurmë të formës së hershme *aki për standarden *elb*.
27. **nuku kam** - Shqipe mod. *nuk kam.* Forma mohore *nuku*, në vend të standardës *nuk*, tani del kryesisht në dialektin jugor të Korçës.
28. **rush** - Shqipe mod. *rrush.*
29. **aki mebe teshin kurd** - E paqartë. Shqipe mod. e mundshme *aki më bjerr, të ikën kryet.
30. **pörtuni zoti nuku kam aki** - Shqipe mod. *për tynëzot nuk kam *aki.*
31. **támu** - Shqipe mod. *t'ëma.* Forma shkodrane: *e ama, t'ama.*
32. **motrá** - Shqipe mod. *motra.*
33. **shoke** - Shqipe mod. *shoqe, shoqja.*
34. **hak mut** - Shqipe mod. *ha mut.* Nuk duket e besueshme, sipas përkthimit turqisht, forma shqipe mod. *hak mut* në kuptimin e shprehjes *ja, e ke hak mutin!*
35. **tikifshati támu** - Shqipe mod. *të qifsha tët amë.* Veta e parë dëshirore e foljes *qij* plus kallëzorja e *jot amë.* Kjo shprehje në formën standarde *të qifsha nënën* është një nga sharjet më të zakonshme që dëgjohen në shqipen e sotme.
36. **tikifshati shoke** - Shqipe mod. *të qifsha tët shoqe.*
37. **ti pirishte bihund** - Shqipe mod. *të pjerdhsha mbë hund,* fyerje që njihet ende në Shkodër. Veta e parë e dëshirores jokalimtare të foljes *pjerdh* plus parafjala gege *mbë* në vend të standarde *në.*
38. **tikifshati büti** - Shqipe mod. *të qifsha (në) bythë.*
39. **iç kivirdim** - Shqipe mod. *i shkërdhyem.* Pjesore e shkuar pësore e foljes *shkërdhej* më mbaresën gege *-yem.* Sharjë e zakonshme në shqipen e sotme, shih formin e folmes së Tiranës *shkërdhatë.*

Përfundim

Evlja Çelebiu është njëherësh shkrimtar me imagjinatë dhe burim i pashtershëm informatash për jetën e përditshme të Shqipërisë së shekullit shtatëmbëdhjetë. Fjalorthi i tij unikal i shqipes i hartuar gjatë qëndrimit në Shkodër më 1662 që ofron çka duhet të dijë një dervish derisa udhëton në tokat e të pabesve për pjesën më të madhe është shënuar me saktësi dhe mund të përdoret edhe sot me ndonjë sukses nga udhëtarët e huaj. Megjithatë, këshillojmë kujdes.

Bibliografi

BABINGER, Franz

Evlja Tschelebi's Reisewege in Albanien.

në: Mitteilungen des Seminars für Orientalische Sprachen, Berlin 33 (1930), II.

Abteilung, f. 138-178. ribtom në: Rumelische Streifen (Berlin 1938) f. 1-40 dhe në:

Aufsätze und Abhandlungen zur Geschichte Südosteuropas und der Levante 2 (Mynih 1966), f. 51-89.

BRAUN, Ludwig & CAMAJ, Martin

Ein albanischer Satz aus dem Jahre 1483.

në: Zeitschrift für Vergleichende Sprachforschung, Göttingen, 86 (1972) f. 1-6.

COHADZIC, Dim. S.

Putopis Evlije Çelebije o srpskim zemljama z XVII veku. Preveo s turskog.

në: Spomenik, Srpska Kraljevska Akademija, Beograd, 42 (1905), drugi razred, 37, f. 1-34.

DANKOFF, Robert

The languages of the world, according to Evliya Çelebi.

në: Journal of Turkish Studies, Kembrixh MA, 13 (1989), f. 23-32.

An Evliya Çelebi glossary. Unusual, dialectal and foreign words in the Seyahat-name.

ne: Sources of Oriental languages and literatures 14. Edited by Sinani Tekin and Gönül Alpay Tekin. Turkish Sources XII. (Department of Near Eastern Languages and Civilisations, Harvard University, Harvard 1991)

ELSIE, Robert

The Albanian lexicon of Arnold von Harff, 1497.

në: Zeitschrift für Vergleichende Sprachforschung, Göttingen, 97, 1 (1984), f. 113-122.

The Bellifortis text and early Albanian.

në: Zeitschrift für Balkanologie, Berlin, 22. 2 (1986), f. 158-162.

History of Albanian literature. East European Monographs 379. ISBN 0-88033-276-X. 2 volumes.

(Social Science Monographs, Boulder. Distributed by Columbia University Press, Nju Jork 1995) xv + 1,054 ff.

Histori e letërsisë shqiptare.

(Dukagjini, Tiranë & Pejë 1997) 686 ff.

EVLIYA, Efendi

Evlijâ Çelebi seyahatnamesi. 10 vëll.

(İqdâm Matbaası, İstanbul [1314 A.H.] 1896-1938 A.D.)

Evliyâ Çelebi Seyâhatnamesi. 15 vëll.

(Zuhuri Danisman Yaninevi, İstanbul 1969-1971)

Seyahatnâme. Giriş. Hazırlayan İsmet Parmaksizoglu.

(Kültür ve Turizm Bakanlığı, Ankara 1983) 350 ff.

Evliya Çelebi Seyahatnamesi. 6 vëll.

(Üçdal Nesiyyat, İstanbul 1984)

KALESHI, Hasan

Kosova e Metohija n'udhëpërshkrimin e Evlija Çelebis.

në: Përparimi, Prishtinë, 7-8 (1955), f. 422-434.

KRASNIQI, Mark

Shqiptarët në udhëpërshkrimin e Evlija Çelebiut.
në: Gjurmë e gjurmime (Tiranë 1982), f. 320-326.

SABANOVIC, Hazim

Evliya Çelebija. Putopis. Odlomci o jugoslovenskim zemljama. Preveo, uvod i komentar
napisao Hazim Sabanovic. 2. izd.
(Svjetlost, Sarajevë 1954; ribotim Veselin Maslesa, Sarajevë 1979) 704 ff.

(Përktheu Rexhep Ismajli)

[botuar në: Studime, Prishtinë, 4 (1997), f. 239-249.]